



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA

ZYRA E KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE/NATIONAL AUDIT OFFICE

Në mbështetje të nenit 9.2 dhe 15.1 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, nenit 5 dhe 6 të Rregullores Nr.01/2017 për Marrëdhënie Punes dhe nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS
për plotësimin e vendeve të punës

I. Pozita:	Auditor për Teknologji Informative
Kodi:	ATI/ZKA/14-08/17
Grada:	Përcaktohet me akt të veçantë
Numri i pozitave:	Dy (2)
Kohëzgjatja:	Me kohë të pacaktuar
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i Pozitës:

Auditimi i Teknologjisë Informative nënkupton një ekzaminim të mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë së kontrolleve të cilat mbrojnë sistemet e aplikimit të TI për të siguruar besueshmërinë, integritetin dhe disponueshmërinë e sistemeve të TI dhe mirëmbajtjen e informacioneve në këto sisteme.

Auditori për TI do të ofroj përkrahje për ekipet e auditimit në identifikimin e sistemeve informative aktualisht në shfrytëzim, duke analizuar qeverisjen, rrezikun dhe përshtatshmërinë e tyre. Po ashtu, si detyra tjera do të jenë edhe kryerja e vlerësimeve profesionale në implementimin, qeverisjen, operimin, mbrojtjen dhe monitorimin e sistemeve informative në shfrytëzim. Auditori i Teknologjisë Informative i raporton Drejtorit të Departamentit të Auditimit.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

1. Kryerjen e monitorimit të sistemeve informative për të siguruar se janë duke u ndjekur politikat dhe praktikat adekuate për TI;
2. Kryerjen e vlerësimit të rreziqeve për sistemet e monitoruara;
3. Kryerjen e intervistave me personat përgjegjës si dhe palët e interesit për të mundësuar dhënien e vlerësimit si dhe verifikimin e të dhënave dhe dëshmive të pranuar;
4. Verifikimin dhe vlerësimin për operacionet e ndërlidhura me sistemet e informacionit;
5. Dokumentimin dhe raportimin për të gjeturat dhe dhënien e opinionit dhe rekomandimeve;
6. Përcjelljen dhe aplikimin e planit të punës të caktuar nga Udhëheqësi i Ekipit, i cili paraprakisht është i aprovuar nga Drejtori i Departamentit;
7. Të ofroj ndihmën si mentor/trajnuar për anëtarët e tjerë të ekipit, në mënyre që çdo anëtar të ofroj ekspertizën e duhur lidhur me TI për fushën që auditohet;
8. Raporton për punën e kryer në baza të përcaktuara kohore tek nivelet menaxhuese.

Kualifikimet minimale, përvoja e punës dhe aftësitë:

- Diplomë fakulteti në fushat relevante të Teknologjisë Informativë;
- Përvojë pune profesionale së paku tri (3) vite;
- Certifikim nga fusha e TI-së, në veçanti ato si CISA, CISM, CISSP, ITIL do të kenë përparësi
- Të ketë njohuri rreth sistemeve të sigurisë profesionale të informacionit, menaxhimit të projekteve, me theks të veçantë të projekteve të TI-së, menaxhimin e shërbimeve, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut dhe përshtatshmërisë, si dhe njohuri rreth standardeve dhe praktikave me të mira të punës në fushën e cila ndërlidhet me këtë pozitë.
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale, aftësi të mira komunikimi verbal dhe në të shkruar në gjuhët zyrtare dhe njohuri të mirë rreth gjuhës angleze.

II. Pozita:	Teknik i Auditimit
Kodi:	AUD/ZKA/15-08/17
Grada:	ZKA/08
Numri i pozitave:	Një (1)
Kohëzgjatja:	Me kohë të pacaktuar
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i Pozitës:

Tekniku i Auditimit ofron mbështetje dhe ndihmon ekipin e auditimit në kryerjen e detyrave të përcaktuara sipas planit vjetor të auditimit. Tekniku i Auditimit mbulon detyrat profesionale me mbikëqyrje dhe udhëzime të herëpashershme nga Udhëheqësi i drejtpërdrejte.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Kryerja e detyrave me përgjegjësi, të caktuara nga UE (nën mbikëqyrje dhe me përkrahje);
- Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës në fushat e caktuara të auditimit;
- Zbatojnë të gjitha standardet e cilësisë të përcaktuara me Doracakun e auditimit të rregullsisë;
- Zbaton të gjitha rregulloret, udhëzimet, politikat dhe procedurat e brendshme të përcaktuara nga ZKA;
- Shfrytëzimi i teknikave të sakta analitike në bazë të dëshmive të mbledhura;
- Përgatitja e LP (memo përmbledhëse) lidhur me auditimin e komponentës apo fushës audituese, e cila i është caktuar; dhe
- Përfundimi dhe indeksimi i letrave të punës dhe diskutimi me kohë me Udhëheqësin e tij/saj.

Kërkesat themelore:

1. Diplomë fakulteti
2. Së paku një (1) vit përvojë pune profesionale në auditim, kontabilitet apo financa
3. Preferohet të ketë një të njërën nga skemat e certifikimit për kontabilist, auditor apo auditor i brendshëm.

Informata të përgjithshme për kandidatët:

Përcaktimi i pagës për pozitat e shpallura bëhet në përputhje me aktet e brendshme të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Procedura e konkurrimit:

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës, të shoqëruar nga një biografi personale (CV), nga një letër motivuese, si dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjet shkollore dhe për përvojën e kërkuar të punës.

Forma e aplikacionit mund të merret në kopje fizike në recepcionin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe mund të shkarkohet nga faqja e internetit e Zyrës Kombëtare të Auditimit: <http://www.zka-rks.org/>

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, mund të dërgohet nëpërmjet e-mailit në adresën: rekrutimi@oagks.org, nëpërmjet shërbimit postar, apo të dorëzohet në kopje fizike në zyrën e Divizionit për Burime Njerëzore të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Afati i dorëzimit të aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit.

Shënim:

Kërkesat e dërguara pas afatit të përcaktuar me konkurs nuk do të shqyrtohen. Të gjitha kërkesat e pakompletuara do të refuzohen. Për shkak të numrit eventual të madh të kërkesave të pranuar, do të kontaktohen vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë.